

UDHËZIM
Nr. 24, datë 20.9.2024

**PËR RREGULLAT PËR MASAT E VEÇANTA TË KONTROLLIT PËR
ÇRRËNJOSJEN DHE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES BRENDË VENDIT TË
KALBËZIMIT KAF *RALSTONIA SOLANACEARUM* (SMITH 1896) YABUUCHI ET
AL. 1996 EMEND SAFNI ET AL. 2014 ¹**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, dhe mbështetur në pikën 3, të nenit 8, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë masat për të çrrënjosur dhe për të parandaluar përhapjen e *Ralstonia solanacearum* (Smith 1896) Yabuuchi *et al.* 1996 emend. Safni *et al.* 2014, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si shkaktari i kalbëzimit kaf të patates.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllim të këtij udhëzimi, termat e përcaktuar në nenin 2, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, dhe në nenin 2, të urdhrit nr. 113, datë 15.3.2022, “Për miratimin e rregullores ‘Për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve’”, të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim.

Ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Dëmtues i specifikuar” është kalbëzimi kaf *Ralstonia solanacearum* (Smith 1896) Yabuuchi *et al.* 1996 emend. Safni *et al.* 2014;
2. “Bimë të specifikuara” është bima e *Solanum tuberosum* L. (patate), përveç farave dhe bimëve, përveç frutave dhe farave të *Solanum lycopersicum* (L.) Karsten ex Farw (domate);
3. “Bimë bujtëse të pakultivuara” janë bimët e egra dhe të kultivuara të Solanaceae;
4. “Bimë të specifikuara të pakultivuara” është bima e specifikuar që shfaqet në vendet e prodhimit pa u mbjellë;
5. “Zhardhokët e destinuar për t’u mbjellë në vendin e tyre të prodhimit” janë zhardhokët e prodhuar në një vend të caktuar prodhimi, të cilët synohen të qëndrojnë përgjithmonë në atë vend dhe nuk synohen të certifikohen.

¹ Ky udhëzim përaftron plotësisht rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2022/1193, datë 11 korrik 2022, duke vendosur masa për të çrrënjosur dhe për të parandaluar përhapjen e *Ralstonia solanacearum* (Smith 1896) Yabuuchi *et al.* 1996 emend. Safni *et al.* 2014.

Neni 3

Vrojtime vjetore

1. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) kryen vrojtime vjetore për praninë e dëmtuesit të specifikuar në bimët e specifikuara brenda territorit të vendit, në ujërat sipërfaqësore që përdoren për ujitjen e bimëve të specifikuara dhe në mbetje të lëngshme, në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

- a) për zhardhokët të ndryshëm nga ato për mbjellje, vrojtimet duhet të përfshijnë:
 - i. marrja e mostrave nga lotet e zhardhokëve në magazinë ose nga kultura në rritje, sa më vonë që të jetë e mundur ndërmjet tharjes së kërcjeve dhe vjeljes;
 - ii. inspektimi vizual i kulturës në rritje, ku është e mundur të identifikohen vizualisht simptomat e dëmtuesit të specifikuar dhe inspektimi vizual i zhardhokëve të prerë, në rastet kur ky inspektim është i përshtatshëm për të zbuluar simptomat e dëmtuesit të specifikuar;
- b) për zhardhokët për mbjellje, përveç atyre që synohen të mbillen në vendin e tyre të prodhimit, vrojtimet duhet të përfshijnë në mënyrë sistematike inspektimin vizual të kulturave në rritje dhe të loteve në magazinë, marrjen e mostrave në magazinë ose marrjen e mostrave nga kulturat në rritje sa më vonë që të jetë e mundur ndërmjet tharjes së kërcjeve dhe vjeljes;
- c) për zhardhokët që synohen të mbillen në vendin e tyre të prodhimit, vrojtimet kryhen në bazë të riskut të identifikuar, në lidhje me praninë e dëmtuesit të specifikuar dhe përfshijnë:
 - i. marrja e mostrave nga lote e zhardhokëve në magazinë ose nga kultura në rritje, sa më vonë që të jetë e mundur ndërmjet tharjes së kërcellit dhe të vjeljes;
 - ii. inspektimi vizual i kulturës në rritje ku është e mundur të identifikohen vizualisht simptomat e dëmtuesit të specifikuar dhe inspektimi vizual i zhardhokëve të prerë, në rastet kur ky inspektim është i përshtatshëm për të zbuluar simptomat e dëmtuesit të specifikuar;
- ç) për sa u përket bimëve të domates, vrojtimet duhet të përfshijnë inspektimin vizual, në momentet e duhura, të paktën kulturave në rritje në vendin e prodhimit të bimëve të destinuara për rimbjellje;
- d) për bimët bujtëse solanaceous, të ndryshme nga bimët e specifikuara dhe ujërat sipërfaqësore dhe mbetjeve të lëngshme, vrojtimet kryhen në përputhje me metodat e duhura dhe sipas rastit, merren mostra.

2. Numri, origjina dhe koha e mbledhjes së mostrave bazohen në parime të shëndosha shkencore dhe statistikore dhe në biologjinë e dëmtuesve të specifikuar, duke marrë parasysh sistemet e veçanta të prodhimit të patates dhe të domates, të rajonit në fjalë.

3. AKVMB-ja i raporton Strukturës Përgjegjëse të Mbrojtjes së Bimëve (SPMB-së), brenda datës 30 prill të çdo viti, rezultatet e vrojtimeve vjetore të kryera gjatë vitit kalendarik paraardhës. Raportimi i rezultateve të vrojtimeve do të bëhet në përputhje me formatin e përcaktuar në aneksin II, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 4

Masat në rast dyshimi për praninë e dëmtuesit të specifikuar

1. AKVMB-ja garanton që mostrat e marra për qëllime vrojtimi u nënshtrohen testeve të zbulimit të përmendura në pikën 2.1, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Në pritje të rezultateve të testeve të zbulimit, AKVMB-ja duhet të:

- a) ndalojë lëvizjen e bimëve të specifikuara nga të gjitha kulturat, lotet ose ngarkesat nga të cilat janë marrë mostrat, përveç bimëve të specifikuara nën kontrollin e tij, për të cilat është vërtetuar se nuk ka risk të identifikueshëm të përhapjes së dëmtuesve të specifikuar;
- b) gjurmojnë origjinën e pranisë së dyshuar;

c) kryejë kontrolle zyrtare të lëvizjes të çdo bime të specifikuar, përveç atyre të përmendura në shkronjën “a”, të prodhuara në vendin e prodhimit nga i cili janë marrë mostrat e përmendura në shkronjën “a”;

ç) ndalojë përdorimin e ujit sipërfaqësor në bimët e specifikuara dhe në bimët të tjera të kultivuara bujtëse solanaceous deri në konfirmimin ose hedhjen poshtë të pranisë së dëmtuesit të specifikuar në ujërat sipërfaqësore, përveç rasteve kur lejon përdorimin e ujit sipërfaqësor në domate dhe bimë bujtëse të tjera solanaceous të kultivuara të rritura në sera, me kusht që uji dezinfektohet me metoda përkatëse të miratuar nga AKVMB-ja.

3. Në pritje të rezultateve të testeve të zbulimit, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV), në bashkëpunim me AKVMB-në garanton që të gjitha elementet e mëposhtme të ruhen dhe arkivohen në mënyrë të përshtatshme:

a) të gjitha zhardhokët e mbetur të mostrave dhe aty ku është e mundur, të gjitha bimët e mbetura të mostrave;

b) ekstraktet e mbetura të bimës të specifikuar, ekstraktet e ADN-së dhe materialet shtesë të përgatitura për testim;

c) kulturën e pastër, kur është e përshtatshme;

ç) të gjithë dokumentacionin përkatës.

4. Kur dyshimi për praninë e dëmtuesit të specifikuar konfirmohet në përputhje me pikën 1.1, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi. AKVMB-ja garanton që testet e përmendura në aneksin I të këtij udhëzimi të kryhen nga ISUV-ja, në mostrat e marra për qëllime të vërtetimit për të konfirmuar ose për të refuzuar prezencën e dëmtuesit të specifikuar.

Neni 5

Masat në rast konfirmimi të pranisë së dëmtuesit të specifikuar

1. Kur prania e dëmtuesit të specifikuar konfirmohet zyrtarisht nga ISUV-ja, në përputhje me pikën 1.2, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi, zbatohen pikat 2 deri në 6 të këtij neni.

2. Kur prania e dëmtuesit të specifikuar konfirmohet në bimë të specifikuara, AKVMB-ja merr menjëherë të gjitha masat e mëposhtme:

a) kryen një hulumtim për të përcaktuar shtrirjen dhe burimin fillestar të infeksionit në përputhje me aneksin III bashkëlidhur këtij udhëzimi, me teste të mëtejshme në përputhje me pikën 1, të nenit 4, të paktën në të gjitha rezervat klonike të zhardhokëve për mbjellje;

b) shpallja e zonës së shënuar, e cila do të përbëhet nga një zonë e infektuar që përmban të gjitha elementet e mëposhtme:

i. bimët e specifikuara, ngarkesat dhe/ose lotet, automjetet, anijet, magazinat ose njësitë e tyre, nga të cilat është marrë një mostër bime e specifikuar e infektuar, çdo objekt tjetër duke përfshirë materialin e ambalazhimit dhe makinerinë e përdorur në prodhimin, transportin ose ruajtjen e bimëve të specifikuara dhe sipas rastit, vendin e prodhimit ose vendin e prodhimit ku bimët e specifikuara janë rritur ose vjelë;

ii. të gjitha kriteret të renditura në shkronjën “i” të përcaktuara se mund të jenë të infektuar nga dëmtuesi i specifikuar, nëpërmjet kontaktit para ose pas vjeljes ose nëpërmjet prodhimit, ujitjes ose spërkatjes së njëkohshme me bimët e specifikuara të infektuara dhe duke marrë parasysh elementet e renditura në pikën 1, të aneksit IV, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

c) vendos kur është e nevojshme për të adresuar riskun fitosanitar, një zonë sigurie rreth zonës së infektuar duke marrë parasysh elementet e një përhapjeje të mundshme të dëmtuesit të specifikuar, siç referohet në pikën 2, të aneksit IV të këtij udhëzimi;

ç) përcakton:

i. kriteret e cituar në shkronjën “i”, “b”, si të infektuar;

ii. kriteret e cituar në shkronjën “i”, “b”, si potencialisht të infektuar.

3. Kur prania e dëmtuesit të specifikuar konfirmohet në kulturat e bimëve bujtëse solanaceous të ndryshme nga bimët e specifikuara dhe kur prodhimi i bimëve të specifikuara identifikohet me risk, AKVMB-ja merr masat e mëposhtme:

a) nisë hulumtim për të përcaktuar shtrirjen dhe burimin fillestar të infeksionit në përputhje me aneksin III, bashkëlidhur këtij udhëzimi, me teste të mëtejshme në përputhje me pikën 1, të nenit 4, të paktën në të gjitha rezervat klonike të zhardhokëve për mbjellje; dhe

b) të shpallin një zonë të shënuar, e cila do të përbëhet nga një zonë e infektuar.

Zona e infektuar duhet të përmbajë, si vijon:

a) bimët bujtëse nga të cilat është marrë mostra e infektuar;

b) bimët bujtëse që mund të infektohen nga dëmtuesi i specifikuar dhe të përcaktuara si të infektuara potencialisht, nëpërmjet kontaktit para ose pas vjeljes ose nëpërmjet prodhimit të njëkohshëm, ujitjes ose fazave të spërkatjes me bimët bujtëse të infektuara.

AKVMB-ja përcakton:

a) bimët bujtëse të referuara në shkronjën “a” të pikës 2 të këtij neni, si të infektuara;

b) bimët bujtëse të referuara në shkronjën “b” të pikës 2 të këtij neni, si potencialisht të infektuara.

4. Kur prania e dëmtuesit të specifikuar konfirmohet në ujërat sipërfaqësore, në shkarkimet e mbeturinave të lëngshme nga përpunimi industrial ose nga ambientet e ambalazhimit që trajtojnë bimë të specifikuara ose në bimë bujtëse të egra të lidhura dhe ku prodhimi i bimëve të specifikuara identifikohet me risk nëpërmjet ujitjes, spërkatjes ose përmytjes me ujë sipërfaqësor, AKVMB-ja merr masat e mëposhtme:

a) nisë një hulumtim në përputhje me aneksin III, bashkëlidhur këtij udhëzimi, duke përfshirë një vërtetim në kohë të përshtatshme mbi mostrat e ujërave sipërfaqësore dhe mbetjeve të lëngshme dhe mbi bimët bujtëse të egra solanaceous, nëse janë të pranishme, në mënyrë që të përcaktohet shtrirja e infeksionit; dhe

b) vendos një zonë të shënuar që përmban një zonë të infektuar duke marrë parasysh elementet e një përhapjeje të mundshme të dëmtuesit të specifikuar, siç përcaktohet në pikën 2, të aneksit IV bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Zona e infektuar duhet të përmbajë, si vijon:

a) ujin sipërfaqësor nga i cili është marrë mostra e infektuar;

b) ujin sipërfaqësor që mund të infektohet, duke marrë parasysh elementet e renditura në pikën 1, të aneksit IV, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

AKVMB-ja përcakton:

a) uji sipërfaqësor i përmendur në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij neni, si i infektuar;

b) ujin sipërfaqësor të përmendur në shkronjën “a” të pikës 2 të këtij neni, si potencialisht e infektuar.

5. Kur një Drejtori Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (DRVMB) pranë AKVMB-së kanë konfirmuar zyrtarisht praninë e këtij dëmtuesi, DRVMB-ja që kufizohet, do të përcaktojë shtrirjen potenciale të infeksionit dhe do të krijojë një zonë të shënuar, në përputhje me pikat 2, 3 dhe 4. Në rast shpërthimi në ujërat sipërfaqësore, nuk kërkohet njoftim sipas nenit 15, të ligjit nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, për ujërat sipërfaqësore të infektuara që janë në zonën e shënuar.

6. ISUV-ja garanton që të gjitha elementet e mëposhtme të ruhen dhe të konservohen siç duhet:

a) materialin e specifikuar në pikën 3, të nenit 4 deri të paktën deri në përfundimin e të gjitha testeve;

b) materialin që lidhet me testin e dytë të zbulimit dhe me testet e identifikimit kur është e përshtatshme, deri në përfundimin e të gjitha testeve;

c) nëse është e aplikueshme, kultura e pastër e dëmtuesit të specifikuar deri të paktën një muaj pas njoftimit.

Neni 6

Masat për çrrënjosjen e dëmtuesve të specifikuar

1. Bimët e specifikuara të përcaktuara si të infektuara nga dëmtues i specifikuar, në përputhje me shkronjën “i”, “ç” të pikës 2, të nenit 5, nuk do të mbillen. AKVMB-ja garanton që bimët e specifikuara të infektuara të shkatërrohen ose të asgjësohen ndryshe në një mënyrë tjetër, në përputhje me pikën 1, të aneksit V, bashkëlidhur këtij udhëzimi, me kusht që të vërtetohet se nuk ka risk të identifikueshëm për përhapjen e dëmtuesve të specifikuar.

Kur bimët e specifikuara janë mbjellë përpara se të përcaktohen si të infektuara, materiali i mbjellë do të shkatërrohet menjëherë ose do të asgjësohet në një mënyrë tjetër, në përputhje me pikën 1, të aneksit V, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Vendndodhja e prodhimit ku janë mbjellë bimët e specifikuara të infektuara duhet të cilësohen si të infektuar. Një zonë e shënuar do të vendoset në përputhje me shkronjën “b” të pikës 2, të nenit 5.

2. Bimët e specifikuara të përcaktuara si të mundshme të infektuara, sipas shkronjës “ii”, “b”, të pikës 2, të nenit 5 dhe bimët e specifikuara për të cilat është identifikuar një risk, sipas pikës 4 të nenit 5, nuk do të mbillen dhe nën kontrollin e AKVMB-së, të vihet në përdorimin ose asgjësimin e duhur, siç përcaktohet në pikën 2, të aneksit V, bashkëlidhur këtij udhëzimi, me kusht që të vërtetohet se nuk ka risk të identifikueshëm për përhapjen e dëmtuesit të specifikuar.

Kur bimët e specifikuara janë mbjellë përpara se të përcaktohen si të mundshme të infektuara, materiali i mbjellë do të shkatërrohet menjëherë ose do të zbatohen masat e specifikuara në pikën 2, të aneksit VI, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Vendndodhja e prodhimit ku janë mbjellë bimët e specifikuara potencialisht të infektuara duhet të përcaktohen si të infektuara potencialisht. Një zonë e shënuar do të krijohet në përputhje me shkronjën “b” të pikës 2, të nenit 5.

3. Çdo makineri, mjet, anije, magazinë ose njësi të tyre, dhe çdo objekt tjetër, duke përfshirë materialin e ambalazhit, të përcaktuar si të infektuar në bazë të shkronjës “i”, “ç” të pikës 2, të nenit 5 ose ndoshta të infektuar sipas shkronjës “ii”, “ç” të pikës 2 të nenit 5, dhe shkronja “b” e nënparagrafit të tretë të pikës “4” e nenit 5, do të shkatërrohen ose do të pastrohen dhe dezinfektohen, duke përdorur metodat e specifikuara në pikën 3, të aneksit V, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Përveç masave të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3, masat e përcaktuara në pikën 4, të aneksit V, bashkëlidhur këtij udhëzimi zbatohen në zonat e përcaktuara.

Neni 7

Masat specifike të testimit për zhardhokët për mbjellje

1. Kur prania e dëmtuesit të specifikuar është konfirmuar zyrtarisht nga ISUV-ja, në një vendndodhje prodhimi të zhardhokëve për mbjellje, AKVMB-ja duhet të garantojnë që testet e përmendura në aneksin I, bashkëlidhur këtij udhëzimi, të kryhen në linjat e lidhura klonisht të loteve të infektuara të zhardhokëve ose kur konstatohet mungesa e linjave të lidhura me klonim, në zhardhokët ose shumë zhardhokët që kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me lotet e infektuara të zhardhokëve.

2. Kur prania e dëmtuesit të specifikuar është konfirmuar zyrtarisht nga ISUV-ja, në vendndodhjet e prodhimit të zhardhokëve për mbjellje në një skemë certifikimi, testet e përmendura në aneksin I, bashkëlidhur këtij udhëzimi, do të kryhen ose në secilën bimë të përzgjedhjes klonale fillestare ose në mostrat përfaqësuese të farërave bazë të patateve.

Neni 8
Dispozitat përfundimtare dhe hyrja në fuqi

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore Veterinare.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 janar 2025.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

ANEKSI I

Skema për testet që do të kryhen në përputhje me nenet 3, 4, 5 dhe 7

1. PARIMET E PËRGJITHSHME MBI PRANINË E DËMTUESIT TË SPECIFIKUAR

1.1. Prania e dëmtuesit të specifikuar dyshohet kur merret një rezultat pozitiv në testin e parë të zbulimit të kryer në bimët e specifikuar ose në mostrat e ujit.

1.2. Prania e dëmtuesit të specifikuar konfirmohet në rastet e mëposhtme:

a) kur testi i parë ose i dytë i zbulimit është një izolim selektiv që rezulton në koloni me morfologji tipike dhe rezultatet pozitive merren në dy teste identifikimi të kryera në koloni;

b) kur testi i parë dhe i dytë janë teste të ndryshme nga një izolim selektiv, dhe rezultatet pozitive merren në dy teste identifikimi pasi mostra i është nënshtruar izolimit selektiv që rezulton në koloni me morfologji tipike.

Një nga këto dy teste, identifikimi do të jetë një test i përmendur në shkronjat “d”, “e” dhe “ë” të pikës 2.2 të këtij aneksi.

2. TESTET

2.1. Testet e zbulimit

Testet e zbulimit duhet të jenë të tilla që të zbulojnë vazhdimisht të paktën 10^4 cells/ml pelet i risuspenduar të marra nga mostrat asimptomatike.

Testi i dytë i zbulimit duhet të bazohet në parime të ndryshme biologjike ose rajone të ndryshme nukleotide nga testi i parë i zbulimit.

Testet e zbulimit janë si më poshtë:

a) testet e imunofluoreshencës, siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

b) izolimi i dëmtuesit të specifikuar në mjedisin gjysmëselektiv të rritjes mSMSA, siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

c) testi konvencional PCR, duke përdorur primerat e Pastrik *et al.*, (2002)², siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

ç) TaqMan® Testet Real-time PCR, duke përdorur primera dhe probe të:

i. Weller *et al.* (2000)³, siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

² Pastrik, K.H., Elphinstone, J.G., Pukall, R. (2002) Analiza e sekuencës dhe zbulimi i *Ralstonia solanacearum* me amplifikimin multipleks PCR të rajonit ndarës ndërgjenik ribozomal 16S-23S me kontroll të brendshëm pozitiv. Gazeta Evropiane e Patologjisë së Bimëve 108, 831–842.

³ Weller, S.A., Elphinstone, J.G., Smith, N., Boonham, N., Stead, D.E. (2000). Zbulimi i shtameve *Ralstonia solanacearum* me një analizë sasiore, multiplekse, në kohë reale, PCR fluorogjenike (TaqMan). Mikrobiologjia e Aplikuar dhe Mjedisore, 66, 2853–2858. <https://journals.asm.org/doi/10.1128/AEM.66.7.2853-2858.2000>

ii. Vreeburg *et al.* (2016)⁴ (duke përdorur një probe TaqMan[®] të modifikuar nga probe origjinale e përshkruar nga Weller *et al.* (2000)), siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

iii. Vreeburg *et al.* (2018)⁵ (i ashtuquajtur test NYtor), siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

iv. Massart *et al.* (2014)⁶, siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

d) Testi LAMP (amplifikimi izotermik i ndërmjetësuar nga cikli), duke përdorur primerat e Lenarčić *et al.* (2014)⁷ (vetëm për material bimor simptomatik), siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit.

2.2. Testet e identifikimit

Testet e identifikimit janë si më poshtë:

a) testet e imunofluoreshencës, siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

b) testet konvencionale PCR, duke përdorur primerat e Pastrik *et al.* (2002), siç përshkruhet me detaje të plota në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

c) TaqMan[®] Testet Real-time PCR, duke përdorur primera dhe probe të:

i. Weller *et al.* (2000), siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

ii. Vreeburg *et al.* (2016) (duke përdorur një probe TaqMan[®] të modifikuar nga probe origjinale e përshkruar nga Weller *et al.* (2000)), siç përshkruhet me detaje të plota në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

iii. Vreeburg *et al.* (2018) (i ashtuquajtur test NYtor), siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

iv. Massart *et al.* (2014), siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

ç) Testi LAMP (amplifikimi izotermik i ndërmjetësuar nga cikli) duke përdorur primerat e Lenarčić *et al.* (2014), siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

d) Testi PCR konvencional i multipleksit specifik për filotipin (Opina *et al.* (1997)⁸; Fegan & Prior (2005)⁹, siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

e) barkodimi i ADN-së (Wicker *et al.* (2007)¹⁰, siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

⁴ Vreeburg, R.A.M., Bergsma-Vlami, M., Bollema, R.M., de Haan, E.G., Kooman-Gersmann, M., Smits-Mastebroek, L., Tameling, W.I.L., Tjou-Tam-Sin, N.N.A., van de Vossen B.T.L.H., Janse, J.D. (2016). Performanca e PCR në kohë reale dhe imunofluoreshencës për zbulimin e *Clavibacter michiganensis* subsp. *sepedonicus* dhe *Ralstonia solanacearum* në zhardhokët e patates në testimin rutinë. Buletini OEPP/EPPO Buletini 46, 112–121.

⁵ Vreeburg, R., Zendman, A., Pol A., Verheij, E., Nas, M., Kooman-Gersmann, M. (2018). Vërtetimi i katër TaqMan PCR në kohë reale për zbulimin e *Ralstonia solanacearum* dhe/ose *Ralstonia pseudosolanacearum* dhe/ose *Clavibacter michiganensis* subsp. *sepedonicus* në zhardhokët e patates, duke përdorur një qasje të regresionit statistikor. Buletini EPPO 48, 86–96.

⁶ Massart, S., Nagy, C., Jijakli, M.H. (2014). Zhvillimi i zbulimit të njëkohshëm të *Ralstonia solanacearum* race 3 dhe *Clavibacter michiganensis* subsp. *sepedonicus* në zhardhokët e patates me një analizë të PCR në kohë reale multipleks. Gazeta Evropiane e Patologjisë së Bimëve 138, 29–37.

⁷ Lenarčić, R., Morisset, D., Pirc, M., Llop, P., Ravnikar, M., Dreo, T. (2014). Amplifikim izotermik i ndërmjetësuar nga laku i sekuencës së gjenit specifik të endoglukanazës për zbulimin e patogjenit bakterial të vyshkjes *Ralstonia solanacearum*. PLoS ONE 9(4), e96027. <https://doi.org/10.1371/journal.pone.0096027>

⁸ Opina, N., Tavner, F., Holloway, G., Wang, J.F., Li, T.H., Maghirang, R., Fegan, M., Hayward, A.C., Viji Krishnapillai, A., Wai-Foong Hong, Holloway, B.W., Timmis, J.N. (1997). Një metodë e re për zhvillimin e sondave të ADN-së të specieve dhe llojeve specifike dhe primerave PCR për identifikimin e *Burkholderia solanacearum* (dikur *Pseudomonas solanacearum*). Gazeta Azi-Paqësori e Biologjisë Molekulare dhe Bioteknologjisë 5, 19–30.


⁹ Fegan, M., Prior, P. (2005). Sa kompleks është “kompleksi i specieve *Ralstonia solanacearum*”. Në *Sëmundja bakterike e vështirës dhe kompleksi i specieve Ralstonia solanacearum* (eds Allen C, Hayward AC & Prior P), f. 449–461. Shoqëria Amerikane Fitopatologjike, St Paul, MN (SHBA).

¹⁰ Wicker, E., Grassart, L., Coranson-Beaudu, R., Mian, D., Guilbaud, C., Fegan, M., Prior, P. (2007). Llojet *Ralstonia solanacearum* nga Martinique French West Indies), që shfaqin një potencial të ri patogjen. Mikrobiologjia e Aplikuar dhe Mjedisore 73, 6790–6801.

ë) MALDI-TOF MS (van de Bilt *et al.* (2018)¹¹, siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit.

3. DIAGRAMI RRJEDHËS I PROCEDURAVE

Diagrami rrjedhës nr. 1: Procedura diagnostikuese për praninë e dëmtuesit të specifikuar në mostrat e bimës së specifikuar




^{a)} Izolimi mund të përdoret si testi i parë ose i dytë i zbulimit. Nëse dyshohet prania e dëmtuesit të specifikuar në mjedisin e rritjes, kolonitë duhet të pastrohen për të marrë kultura të pastra mbi të cilat do të kryhen dy teste identifikimi.

^{b)} Një nga këto dy teste identifikimi do të jetë një test i përmendur në shkronjat “d”, “e” dhe “ë” në pikën 2.2 bashkëlidhur këtij aneksi. Dy rezultatet pozitive në testet e identifikimit kërkohen për të konfirmuar praninë e dëmtuesit.

^{c)} Testi i tretë i zbulimit do të bazohet në parime të ndryshme biologjike ose në rajone të ndryshme nukleotide.

Diagrami rrjedhës nr. 2: Procedura diagnostikuese për dëmtuesin e specifikuar në mostrat e ujit

¹¹ van de Bilt, J.L.J., Wolsink, M.H.L., Gorkink-Smits, P.P.M.A., Landman, N.M., Bergsma-Vlami, M. (2018). Aplikimi i spektrometrisë masive të jonizimit të desorbimit me laser të asistuar me matricë për identifikimin e shpejtë dhe të saktë të *Ralstonia solanacearum* dhe *Ralstonia pseudosolanacearum*. Gazeta Evropiane e Patologjisë së Bimëve: <https://doi.org/10.1007/s10658-018-1517-5>.



^{a)} Një nga këto dy teste identifikimi do të jetë një test i përmendur në shkronjat “d”, “e” dhe “f” në pikën 2.2. Rezultatet pozitive në dy testet e identifikimit kërkojnë për të konfirmuar praninë e dëmtuesit.

4. PËRGATITJA E MOSTRAVE

4.1. Mostrat nga zhardhokët asimptomatike

Mostra standarde duhet të përmbajë 200 zhardhokë për testim. Procedura e përshtatshme laboratorike për përpunimin e bërthamave për të marrë ekstraktin për zbulimin e dëmtuesit të specifikuar është përshkruar në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit.

4.2. Mostrat nga bimë të specifikuar asimptomatike

Zbulimi i infeksioneve të fshehtë (latent) do të kryhet në mostrat e përbëra të segmenteve të kërcellit ose bishtave të gjetheve. Procedura mund të aplikohet për deri në 200 pjesë të kërcellit ose 200 gjethe nga bimë të ndryshme në një mostër. Procedura e përshtatshme laboratorike për të dezinfektuar dhe për të përpunuar segmentet e kërcellit ose gjetheve për të marrë ekstraktin për zbulimin e dëmtuesit të specifikuar përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit.

4.3. Mostrat nga materiali simptomatik i bimëve të specifikuar

Seksionet e indeve duhet të hiqen në mënyrë aseptike nga unaza vaskulare në një zhardhok patateje ose nga enët vaskulare në kërcellin e bimëve të specifikuar që shfaqin simptoma të tharjes. Procedura e përshtatshme laboratorike për përpunimin e këtyre indeve për të marrë ekstraktin për zbulimin e dëmtuesit të specifikuar është përshkruar me detaje të plota në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit.

4.4. Mostrat e ujit sipërfaqësor ose riqarkullues (përfshirë përpunimin e patates ose rrjedhjet e ujërave të zeza)

Testi kryesor për zbulimin e dëmtuesit të specifikuar në mostrat e ujërave sipërfaqësore, ujit nga sistemet e riqarkullimit dhe mostrat e efluentit (industria e përpunimit të patates) është izolimi selektiv.

Procedura e përshtatshme laboratorike për përpunimin e mostrave të ujit është përkrahur në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit

ANEKSI II

Modeli i vrojtimit referuar në pikën 3 të nenit 3

Formati për paraqitjen e rezultateve të vrojtimit të kalbëzimit kaf për vjeljen e patates dhe të domateve të vitit kalendarik paraardhës.

Kjo tabelë përdoret vetëm për rezultatet e vrojtimit për patatet dhe domatet e vjela.

Kategoria	Zona e mbjelljes (ha)	Testimi laboratorik						Inspektimi vizual i zhardhokëve ⁽¹⁾			Inspektimet vizuale të kulturave në rritje ⁽¹⁾			Informacioni tjetër
		Numri i mostrave	Numri i lot-ëve	Madhësia e lot-ët (në t ose ha)	Përiudha e mostrimit	Jo pozitive		Numri i mostrave të infektuara	Madhësia e mostrës	Nr. i mostrave	Numri i inspektimeve vizuale	Nr. i ha (patate) ose bimë (domate)	Nr. i rezultateve pozitive ⁽²⁾	
						Mostrat	Lotet							
Zhardhokët e certifikuar për mbjellje														
Zhardhokët e tjerë për mbjellje (specifikoni)														
Mallra dhe patatet e përpunuar														
